



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT  
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION  
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE  
NAUKU I TEHNOLOGIJU

Kabineti I Ministrit

Office of the Minister

Kabinet Ministra

## UDHËZIM ADMINISTRATIV

**Organizimi i mësimit zgjedhor në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar**

**NUMËR: MASHT [I] 1/2005**

**DATË: 06.01.2005**

Në përputhje me nenin 1.3 pika ç) të Rregullorës së UNMIK-ut nr.2001/19, nenit 42 të Ligjit Mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë (në vijim LAFM), Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (më tej MASHT) rregullon çështjen si më posht:

### **Neni 1 Qëllimi**

Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim që të ua mundësojë shkollave që për MËSIMIN ZGJEDHOR të bëjnë vet organizimin: lëndet që do të mësohen, të hartojnë vet planet dhe programet për ato lëndë.

### **Neni 2 Përkufizimi**

**2.1.** Quhet MËSIM ZGJEDHOR, sepse nxënësit e zgjedhin sipas dëshirës, dhuntisë, nevojës apo interesit.

**2.2.** Lënda, kursi apo veprimtaria për mësimin zgjedhor mund të sygjerohet nga Ministria e Arsimit,

Shkencës dhe Teknologjisë ose në bazë të kërkesës së nxënësve, prindërve, arsimtarëve, apo të komunitetit.

**2.3.** Në mënyrë të veçantë, do të ishte dashur të konkurojnë arsimtarët e papunë me projekt komplet (lëndën, kursin apo veprimtarinë dhe planin, programin, tekstin dhe mënyrën e realizimit).

### **Neni 3**

#### **Mënyra e organizimit**

**3.1.** Mësimi zgjedhor mund të organizohet për:

Lëndë apo kurse të reja ( p.sh. edukimi qytetarë, etika, kurse shëndëtsore, të drejtat dhe liritë e njeriut, edukimi për ndërmarrës, teknologjia e informimit dhe e komunikimit, mbrojtja e mjedisit jetësor, shkathtësitë jetësore, edukimi rural, AIDS-it apo çkado tjetër që është joshëse për nxënësit dhe më interes për komunitetin.

### **Neni 4**

#### **Kohëzgjatja**

Lënda, kursi apo veprimtaria për mësim zgjedhor duhet të zgjatë jo më pakë se tre (3) muaj.

### **Neni 5**

#### **Mënyra e deklarimit**

**5.1.** Për lëndën, kursin apo veprimtarinë duhet të deklarohen më se paku 15 (pesëmbëdhjetë) nxënës (në qoftë se klasa ka më shumë se një paralele)

**5.2.** Në qoftëse klasa ka vetëm një paralele, atëherë është e nevojshme që për lëndën, kursin apo veprimtarinë të deklarohen se paku gjysma e paraleles- në mënyrë që të mund të organizohet mësimi zgjedhor.

### **Neni 6**

#### **Mënyra e vendosjes**

**6.1.** Për mësimin zgjedhor, në bazë të kërkesave të të interesuarve, vendosin organet profesionale të shkollës në bashkëpunim më Zyrën Rajonale të Arsimit para fillimit të vitit shkollor.

**6.2.** Për mënyrën e deklarimit të nxënësve, prindërve apo të interesuarve të tjerë dhe kohën kur ata e bëjnë këtë, vendosin organet e shkollës, por gjithsesi e tërë procedura duhet të kryhet para fillimit të vitit shkollor.

### **Neni 7**

#### **Plani dhe programi**

Planet dhe programet për mësimin zgjedhor i harton shkolla në bashkëpunim me Zyrën Rajonale të Arsimit dhe profesionistë të lëmive përkatëse nga komuniteti (në qoftë se ka të tillë).

## **Neni 8**

### **Statusi**

Mësimi zgjedhor kur të aprovohet nga organet profesionale të shkollës e ka statusin e mësimit të rregullt, më të vetmin përjashtim që mësimi zgjedhor do të vlerësohet me notë përshkruese :arritje shumë e lartë, arritje e lartë, arritje e kënaqshme, arritje e kufizuar që realizohet sipas nenit 11. (11.1.- 11.4.) të UA. nr.50/04.

## **Neni 9**

### **Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga Ministri.

---

Agim Veliu, Ministër